



Prishtinë, 12 korrik 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1015_20218

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 16 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike,
- Dispozitat e Nenit 11 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit,
- Kodin e Rrjetit – Kodin e Kçjes, dhe
- Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 05.04.2018 për shqyrtimin dhe aprovimin e amandamentimeve në dokumentin “Metodologjia e Taksave të Kçjes në Rrjetin e Transmetimit”

në seancën e mbajtur me datë 12.07.2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohen** amandamentimet në dokumentin “Metodologjia e Taksave të Kçjes në Rrjetin e Transmetimit” e KOSTT-it

A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 05.04.2018 ka pranuar kërkesën e KOSTT për amandamentimin e Metodologjisë së Taksave të Kçjes në Rrjetin e Transmetimit. Në dokument janë bërë përshtatje të dispozitave ligjore dhe rregullative në harmoni me rrethanat dhe përvojën në çështjet specifike të kçjeve. Ndryshimet më të rëndësishme janë bërë të definimi i pikës së kçjes duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e kalkulimit të nominimeve dhe obligimeve të shfrytëzuesve të sistemit që kanë një pikë të përbashkët të kçjes. Përveç kësaj janë bërë edhe disa ndryshime plotësime rreth përgjegjësisë në mes aplikuesit dhe KOSTT, pastaj është definuar taksa për shërbime, për mirëmbajtjen e asetëve të investuara nga aplikuesit e kçjes përfshirë kompensimin nga kçja e aplikuesve të rijë. Janë bërë edhe disa ndryshime në kostot e pajisjeve dhe shërbimeve si dhe përmirësime teknike dhe gjuhësore.



- ZRRE ka dhënë komente në amandamentimet në dokumentin e Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit, si dhe ka mbajtur takime me KOSTT për të kontribuar në përgatitjen e dokumentit.
- Pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, KOSTT serish ka dërguar dokumentin final për miratim në ZRRE, ndërsa pas analizave të bëra në ZRRE janë bërë edhe disa ndryshime në disa nga pikat e dokumentit.
- Përfundimisht pas vlerësimit të dokumentit, Bordi i ZRRE-së ka aprovuar amandamentimin e Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit.
- Të gjitha dispozitat tjera të Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit do të mbesin në fuqi.


II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti. Dokumenti do të publikohet edhe në faqen elektronike zyrtare të KOSTT.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund ti drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Shtojcë: **Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit e amandamentuar.**

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rüşiti, anëtar

Vendimi dhe dokumenti i amandamentuar i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.